

## NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Vahid Halili, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues, e Abdullah Ahmeti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtëse, në lëndën penale të pandehurit I.A., nga Beogradi, për shkak të veprës penale blerja, posedimi ose shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje, nga neni 273 par.2, lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë dhe mbrojtësit të pandehurit, av.B.K., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.563/2016, të dt.06.04.2017 në seancën publike të kolegjit të mbajtur me dt.15.06.2017, e në prezencën e përkthyesit gjyqësor Elez Baxhaku, morri këtë:

## AKTGJYKIM

I. Me aprovimin e pjeshëm të ankesës së mbrojtësit të pandehurit I.A., av.B.K., e sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.563/2016, të dt.06.04.2017, përkitazi me cilësimin ligjor dhe vendimin mbi dënimin me gjobë, ashtu që Gjykata e Apelit, të pandehurin I.A., për veprën penale blerja, posedimi ose shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje, nga neni 273 par.2, lidhur me nenin 31 të KPRK, e më afër të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit e cilëson në veprën penale blerja, posedimi ose shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje, nga neni 273 par.2 të KPRK dhe për këtë vepër penale të pandehurit ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 4.000(katërmijë)Euro, të cilin dënim të shqiptuar me gjobë i pandehuri detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse të njëjtin nuk e paguan në afatin e caktuar, dënimi i shqiptuar me gjobë, do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20Euro, do ti llogaritet një ditë burg, ndërsa dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite e 6(gjashtë)muaj, merret si i vërtetuar, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.25.05.2016, e tutje.

II.Ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, refuzohet si e pabazuar.

III.Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

## Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.563/2016, të dt.06.04.2017, i pandehuri I.A., është shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi ose shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje, nga neni 273 par.2, lidhur me nenin 31 të KPRK dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vitesh e

6(gjashtë)muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.25.05.2016, e deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi dhe me dënim me gjobë në shumë prej 8.000(tetë mijë)Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta përmbushë në afat prej 2(dy)muajsh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që një natë burgim do të llogaritet 20Euro.

Ndaj të pandehurit I.A., shqiptohet dënimi plotësues konfiskohet-substanca narkotike prej 13kg e 657.6gr dhe vetura e tipit "Citroen Zsara", ngjyrë hiri të mbyllet me targa të Republika e Serbisë NN123NN, kjo veturë ti dërgohet Agjencionit mbi konfiskimin e pasurisë.

I pandehuri është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesë:

-Prokuroria Themelore- DKR në Prinen, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të pandehurit ti shqiptohet dënim më i ashpër me burgim dhe me gjobë për veprën e kryer penale.

-Mbrojtësi i të pandehurit I.A., av.B.K., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe aktgjykimin e shkallës së parë, ta ndryshoj duke i shqiptuar një dënim me burgim më të butë si dhe dënimin me gjobë në lartësi prej 8.000Euro ta zbutë.

-Prokuroria e Apelit, me shkresën e saj PPA/I.nr.257/2016, të dt.30.05.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e PTH-DKR në Prishtinë dhe mbrojtësit të pandehurit I.A., av.B.K., ka propozuar që ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, të aprovohet dhe të pandehurit ti shqiptohet dënim më i lartë me burgim dhe me gjobë, ndërsa ankesa e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, caktoi seancën e kolegjit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, në të cilën morën pjesë i pandehuri I.A., mbrojtësit e tij av.B.K. dhe av.Behar Ejupi, si dhe interpreti i kësaj gjykate Elez Baxhaku, ndërsa në seancë nuk mori pjesë Prokurori i Apelit, edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të PTH-DKR në Prishtinë dhe mbrojtësit të pandehurit I.A., edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, e duke marrë parasysh edhe sqarimin e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të pandehurit I.A., av.B.K., është pjesërisht e bazuar, ndërsa ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, refuzohet si e pa bazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, në ankesën e sajë pretendon se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK, për arsye se sanksioni penal është i butë, pasi që gjykata si rrethanë lehtësuese ka marrë të paktën se i pandehuri ka pranuar fajësinë, ka pranuar se nuk do të përsëris apo do të kryej ndonjë veprë penale, mirëpo, gjykata nuk ka vlerësuar drejtë rrethanat të cilat ndikojnë që dënimi të jetë adekuat me shkallën e lartë të dashjes me rastin e kryerjes së veprës penale nga ana e të pandehurit dhe me këtë dënim nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë si në nenin 41 të KPK.

Mbrojtësi i të pandehurit në ankesën e tij, pretendon se vendimi mbi dënimin me burgim dhe dënim me gjobë, janë tejet të larta dhe gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte se i pandehuri asnjëherë nuk ka ra në kundërshtim me ligjin dhe ka shprehur keqardhje të thellë dhe të sinqertë gjatë procedurës penale dhe dënimi i shqiptuar në kohëzgjatje prej 2(dy)vite e 6(gjashtë)muaj, dhe dënim me gjobë në shumë prej 8.000(tetë mijë)Euro, është tejet i lartë.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e të pandehurit, e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 dhe shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitën e nenit 385 par 1 të KPP, e që ka të bëjë me shkeljen e ligjit penal, Gjykata e Apelit ndryshoj cilësimin ligjor të veprës penale blerja, posedimi ose shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje, nga neni 273 par.2, lidhur me nenin 31 të KPRK, kjo për arsye se nga përshkrimi faktik i dispozitivit të aktgjyimit edhe nga shkresat e lëndës nuk rezulton se i pandehuri të ketë vepruar në bashkëkryerje edhe me personat të tjerë, dhe për këtë arsye gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formohen elementet e veprës penale blerja, posedimi ose shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje, nga neni 273 par.2 të KPRK, e jo se i pandehuri të ketë vepruar në bashkëkryerje dhe për këtë arsye është bërë edhe ri cilësimi i veprës penale dhe me këtë është evituar edhe shkelja e ligjit penal.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e PTH-DKR në Prishtinë, se nuk është vlerësuar dashja e lartë e të pandehurit, janë të pa qëndrueshme dhe ky pretendim ankimor nuk mund të qëndroj për arsye se dashja (qëllimi), është përfshirë në vet veprën penale dhe sikur të vlerësohej edhe nga Gjykata e Apelit, do të bëhej vlerësimi i dyfishtë i rrethanave rënduese, në ankesë Prokuroria Themelore, nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese që kishte me ndikuar në ashpërsimin e dënimit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe shqiptimin e dënimit me gjobë, nuk ka vlerësuar drejtë dispozitën e nenit 73 par.5 me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, edhe pse është detyrimi i gjykatës që të vlerësoj drejtë gjendjen pasurore të pandehurit me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, e i cili dënim duhet të jetë në proporcion me gjendjen pasurore-ekonomike, gjendjen personale të pandehurit, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se i pandehuri është i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar dhe babë i dy fëmijëve, e nga kjo del se gjykata nuk ka vlerësuar gjendjen ekonomike në mënyrë të drejtë dhe për këtë arsye gjykata e Apelit, e ndryshoi vendimin mbi dënimin e shqiptuar me gjobë dhe të pandehurit ia shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej

4.000(katërmijë)Euro, i cili dënim është në proporcion të plotë me kryerjen e veprës penale dhe shkallën e peshës penale të pandehurit, ndërsa sa i përket dënimit të shqiptuar me burgim gjykata e shkallës së parë, drejt ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit mbi dënimin me burgim duke marr parasysh , pranimin e fajësisë, keqardhjen dhe pendimin e thellë të pandehurit, dhe dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite e 6(gjashtë)muaj, e në të cilin dënimi është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.25.05.2016, e tutje është në përpjesëtim në mënyrën dhe rrethanat me të cilat është kryer vepra penale si dhe me peshën e veprës penale, dhe me shqiptimin e dënimit me gjobë dhe me burgim, pritet të arrihet edhe që të pandehurin ta parandaloj nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëhet rehabilitimi i tij, si dhe të parandaloj të tjerët nga kryerja e veprave penale të tilla apo të ngjashme dhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ndryshuar u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në konformë të nenit 403 par.1 të KPP.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.264/2017, me dt.15.06.2017**

**Procesmbajtës,**

**Bujar Balaj**

**Anëtarët e kolegjit,**

**Fillim Skoro**

**Abdullah Ahmeti**

**Kryetari i kolegjit,**

**Vahid Halili**